

AKT-THEMELIMI

SHOQERISE TREGTARE "IMAO PARFUMS" shpk

Ne baze te ligjit 9901 dt 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" , te ligjit 9723 dt 3.05.2007"Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" , te ligjit 129/2014 " Per disa shtesa dhe ndryshime te ligjit 9901 dt 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare " i ndryshuar , **sot me dt 13 Qershor 2024** behet themelimi I Shoqerise **"IMAO PARFUMS" shpk** me seli ne Elbasan nga ortaket :

- 1.z **Laoren Mançka** I biri Ekuranit i dt lindjes 20/01/1992 lindur ne , Elbasan ,dhe banues ne Elbasan, i pajisur me karte identiteti nr 036598802 dhe nr personal J20120090Q.
2. z. **Edison Çollhaj** I biri Sokolit i dt lindjes 13/06/2000, e lindur ne Peqin ,Elbasan dhe banus ne Peqin Elbasan , i pajisur me karte indentiteti nr 033421044 dhe nr personal K00613023Q.

VENDOSEN

Te krijoje nje Shoqeri Tregtare te emertuar **"IMAO PARFUMS" shpk** me kushtet e meposhtme :

NENI 1

Themeluesit me cilesine e ortakeve krijojne shoqerine tregtare **"IMAO PARFUMS" shpk** me status juridik te nje shoqerie me pergjegjsi te kufizuar ne kuptim te ligjit 9901 dt 14.04.2008"Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe ligjit 129/2014 , me kontributet e tyre ne para dhe ne natyre .

NENI 2

Shoqeria gezon statusin e personit juridik dhe veprimtaria e saj do te rregullohet nga legjislacioni Shqiptar ne fuqi ,nga ky Akt-Themelim dhe statutin bashkelidhur

NENI 3

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj me emertimin **"IMAO PARFUMS" shpk** , emer ky qe do te shenohet ne te gjitha dokumentat , letrat faturat etj.

Ajo ka vulen e saj ne te cilen eshte shkruar **"IMAO PARFUMS" shpk Elbasan Albania**

NENI 4

Shoqeria **"IMAO PARFUMS" shpk** e ka seline e saj ne Elbasan Lagjia '11 Nentori' Zona Kadastrale nr.8525 Numer Pasurie 11/120-n3.

Ajo mund te hape perfaqesi, dege ose filiale edhe ne qytete te tjera te Shqiperise

NENI 5

Afati veprimtarise te Shoqerise do jete I pakufizuar me perjashtim te rastit ku ortaku e kesaj shoqerie do te vendosin prishjen e saj.

NENI 6

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj me objekt :

“Shitje me shumice dhe pakice e parfumeve dhe artikuj të tjere kozmetike .”

NENI 7

Me vendim të themeluesve të saj shoqëria mund ta ndryshojë emrin, seline, formën juridike dhe objektin e veprimtarisë, pas berjes së ndryshimeve përkatëse në statut dhe në këtë Akt Themelimi.

NENI 8

Kapitali themeltar i kësaj shoqërie përfaqson kontributet në para në vlerën 100.000 lek (njqindmije)leke.

Ortaket janë e kësaj shoqërie z **Laoren Mançka** me 50% të aksjoneve të kapitalit të shoqërisë dhe z **Edison Çollhaj** zoterues me 50% të aksjoneve të kapitalit të shoqërisë.

NENI 9

Shoqëria kryen veprimtarinë e saj për të realizuar fitime. Ajo është përgjegjëse për detyrimet që ka ndaj shtetit dhe personave të tjerë.

NENI 10

Percaktimi i strukturs organizative të shoqërisë, nr punonjësve, dhe emerimet e shkarkimet në organet e shoqërisë behen me vendim të asmblesë të ortakeve të saj .

Administratori i shoqërisë emërohet z. Edison Çollhaj i biri Sokolit i dt lindjes 13/06/2000, e lindur në Peqin ,Elbasan dhe banues në Peqin Elbasan , i pajisur me kartë indentiteti nr 033421044 dhe nr personal K00613023Q , me kohë zgjatje deri 5 vjet.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënjet me të tretet në emer të shoqërisë si dhe ato të percaktuara në ligjin 9901 dt 14..04.2008 dhe ligjit129/2014

NENI 11

Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj administruese, ekonomike , financiare në përputhje me legjisllacionin përkatës në fuqi dhe dispozitat e statutit bashkelidhur.

Shoqëria do të drejtohet nga organet drejtuese që përbehen ortaket z Laoren Mançka dhe Edison Çollhaj , si dhe administratori i cili është z Laoren Mançka , me vendim të vecantë do të emërojnë një ekspert kontabel. Shoqëria do të mbaje llogaritë në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe do të krijojë fonde rezerve . Fitimi neto që do të rezultojë në fund të çdo viti financiar pas zbritjes së fondit rezerve dhe humbjeve të mbartura nga vitet e mëparshme do të kalojnë ortakut/ve.

NENI 11

Rregullat për drejtimin ,organizimin dhe prishjen e shoqërisë janë percaktuar në statutin e shoqërisë që i bashkelidhet këtij Akt Themelimi



THEMELUSIT E SHOQERISE TREGTARE" IMAO PARFUMS" shpk

ORTAKET

Z. LAOREN MANÇKA

Z. EDISON ÇOLLHAJ

